

VENDIM
Nr. 682, datë 29.7.2015

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E
PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË
JASHTË VENDBANIMIT**

(ndryshuar me VKM 1102, datë 28.12.2015, nr. 398, datë 3.5.2017,¹ nr. 624, datë 1.11.2017, nr. 753, datë 23.9.2020)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 5, 6, 19 dhe 28, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportin rrugor”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:

a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimi fillor, arsimi të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator), të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përbërshëm të tyre, në largësinë mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim;

b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përbërshëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht);

Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht).

c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.

d) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në institucionet arsimore publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përbërshëm.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore) miratojnë hartën e linjave, mbështetur në numrin e punonjësve mësimorë, nxënësve dhe fëmijëve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, sipas kriterëve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi. Njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore), pas hartimit të listave të përfituesve, i konfirmojnë ato edhe te njësitë e vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përbërshëm.

3. Njësitë arsimore (drejtoritë rajonale arsimore/zyrat arsimore), mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, prokurojnë fondet publike për shërbimin e transportit të fëmijëve, nxënësve dhe punonjësve arsimorë sipas hartës së linjave të shërbimit të transportit publik, të licencuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose qendrore.

4. Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të

¹ Sipas pikës 3 të VKM nr. 398, datë 3.5.2017: “3. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë nënshkruar kontrata për shërbimin e transportit të nxënësve dhe mësuesve për vitin buxhetor 2017 para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ky vendim do të zbatohet duke filluar nga data 1.1.2018. Për të gjithë rastet e tjera, vendimi do të zbatohet duke filluar nga data 1.7.2017.”

transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, njësitë arsimore vendore realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, të përfituesve ose prindërve të nxënësve apo nëpërmjet shërbimit postar, për ato rrethe/ zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 4 të këtij vendimi.

Masa e shpenzimeve përlogaritet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të nxënësve dhe mësuesve që kanë ndjekur mësimin, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar, indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

5. Punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar, që përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit të siguruar nga njësitë arsimore vendore, të parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë shpërblim mujor të diferencuar, sipas pikës 4, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", sipas distancave, si më poshtë vijon:

a) në masën 1 000 (njëmijë) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përbërshëm i tyre/ qendra e punës deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 5 km deri në 10 km;

b) në masën 1 500 (njëmijë e pesëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përbërshëm/ qendra e punës deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 10 km deri në 20 km;

c) në masën 2 700 (dymijë e shtatëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përbërshëm/ qendra e punës deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 20 km.

5/1. Njësitë arsimore vendore dhe njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve dhe largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në mënyrë periodike, çdo tre muaj, sipas udhëzimeve të ministrit përgjegjës për arsimin dhe sportin.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i përvitshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e cila transferon fondet përkatëse te njësitë e qeverisjes vendore, dhe nga buxheti i vetë njësisë së qeverisjes vendore, në rastet kur tejkalohet numri i përfituesve, sipas pikës 5/1, të këtij vendimi.

7. Vendimi nr. 709, datë 5.10.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit", shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, njësitë arsimore vendore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama